

I. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Mekanikës së Strukturave, kërkon të punësojë 2 (dy) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë asistent-lektor për grup-lëndët “Mekanika Racionale”:

A-KRITERE KUALIFIKUESE:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në degën Ndërtim ose Hidroteknikë dhe të ketë fituar diplomën Master Shkencor ose diplomën e integruar të studimeve 5-vjeçare në Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimit në vend ose në fakultete të huaja analoge.
2. Të ketë përfunduar studimet universitare me notë mesatare të përgjithshme jo më pak se 8 (tetë).

B- KRITERE VLERËSUESE

Kandidati ose kandidatja do të vlerësohet nëse:

1. Ka notë mesatare të grup lëndëve të Departamentit Mekanikës së Strukturave mbi 9.00.
2. Është në proces doktore ose mban gradën shkencore “Doktor” në fushën e studimeve inxhinierike që kanë lidhje me DMS.
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie dhe veprimtari didaktike në lëndët e DMS, në veçanti në grup lëndët “Mekanika Racionale”
4. Të ketë veprimtari kërkimore shkencore në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe në veçanti me çështje që mbulojnë lëndët e DMS.

Për vlerësimin e kandidatëve do të shërbejnë të gjithë kriteret vlerësuese të sipërpërmendura, me peshë të njëjtë në vlerësim.

II. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Mekanikës kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë Lektor për lëndët:

1. Sistemet e transportit dhe mobiliteti, Cikli Master Shkencor;
2. Sisteme transporti dhe planifikim transporti, Cikli Master Profesional;
3. Analiza e aksidenteve rrugore, Cikli Master Profesional;
4. Shkenca e konstruksioneve 2, Cikli Master Shkencor;
5. Teoria e sistemeve mekanike, Cikli Bachelor.

Kriteret e propozuara për kandidatët janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet në degën Inxhinieri Mekanike, Master Shkencor Konstruksione dhe Mjete Lëvizëse, ose Sistemi i vjetër Inxhinieri Mekanike, drejtimi Transport.
2. Të ketë përgatitur pranë Departamentit të Mekanikës disertacionin për gradën shkencore “Doktor”.

3. Preferohet mesatare konform kriterëve të pranimit dhe në mënyrë të veçantë në disiplinat e njëjta apo të përafërta me vendin vakant të ofruar.
4. Preferohet një angazhim i vlerësuar i kandidatit me aktivitete mësimore, shkencore e ndihmëse të zhvilluara në Departament.

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **09.10.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.